



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1781/2prot.,

Datë 17.08.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Riviera Company 2008” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë E Kufizuar” me Nr. REF-34547-06-27-2022, me objekt “Nderhyrja rigjenerimi urban ne fshatra me potencial turistik (Vermosh, Lepush, Curraj i Eperm, Shishtavec, Radomir dhe Rabdish etj.)” me fond limit 187 500 000, *(njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë)* pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Riviera Company 2008” SHPK.
Adresa: Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr. 1, në zonë kadastrale 2066, Nr. Pasurie.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “M.Gjollesha, ish-Godina ISTN (pranë IKMT),
Tiranë

Në datën 16.08.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1781 protokolli, datë 16.08.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2452 e operatorit ekonomik “Riviera Company 2008” SHPK për procedurën e “Procedurë E Kufizuar” me Nr. REF-34547-06-27-2022, me objekt “Nderhyrja rigjenerimi urban ne fshatra me potencial turistik (Vermosh, Lepush, Curraj i Eperm, Shishtavec, Radomir dhe Rabdish etj.)” me fond limit 187 500 000, *(njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë)* pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me

vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Riviera Company 2008” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Riviera Company 2008” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1781/2022 prot., datë 16.08.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2452. Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Ju s'kualifikoheni pasi nuk plotesoni kriteret e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit:

Ndërhyrjet e parashikuara për këtë objekt prokurimit përfshijnë sistemim, rikonstrukcion dhe/apo adaptim i hapësirave publike, mobilimi urban dhe integrim i funksioneve të përdorimit për ambiente dhe hapësira çlodhje, rekreacioni, loje dhe sporti dhe si të tilla bejne pjese ne Seksionin II. Strukturat ne Ambientet e jashtme dhe pjeserisht ne Seksionin III. Vepra inxhinierike sipas percaktimit ligjor te kategorive te punimeve ne VKM 354, date 11/05/2016. Ndersa punimet e paraqitura nga operatori ekonomik Company Riviera 2008 sh.p.k, ne pjesen me te madhe te tyre keto kontrata jane kontrata per punime ne ndertesa dhe ndarje funksionale te tyre (Seksioni I – VKM 354) dhe kontrata per punime per struktura te transportit te qarkullimit (asfaltime, rruge, etj (Seksioni IV – VKM 354), qe kane elemente te paket ose te ndryshem nga ato te kerkuar per nderhyrjen e kerkuar. Per sa i perket aspekteve te krahasimit dhe ndryshimeve te objekteve te paraqitur si te ngjashem (natyren e ngjashme), sqarojme se ne menyre kumulative objekt e paraqitura ndryshojne ne te gjitha aspektet e meposhtme sikurse jane: i) ne rradhe te pare ka ndryshime sipas percaktimit ligjor te kategorive te punimeve ne VKM 354, date 11/05/2016 ii) ne rradhe te dyte ka ndryshim ne objektin e punes duke e konsideruar vepren e kerkuar si produkt ne fund te proceseve te punes midis kontratave te paraqitura nga operatori ekonomik dhe ato te kerkuara per objektin e tenderit; iii) ne rradhe te trete ka ndryshime ne metodologjine e punes dhe ne pjesen me te madhe te zerave te punimeve midis kontratave te paraqitura nga operatori ekonomik dhe ato te kerkuara per objektin e tenderit; iv) dhe ne fund ka ndryshime ne teknologjine dhe materialet e perdorura per proceset e punes midis kontratave te paraqitura nga operatori ekonomik dhe ato te kerkuara per objektin e tenderit. Per sa i perket punimeve qe kane natyren, ngjashmerine, kompleksitetin dhe elementet e ngjashem me nderhyrjen e kerkuar, konstatohet se keto nuk arrijne vleren 50% per nje kontrate te vetme të ngjashme dhe as vleren 200 % per shume kontrata per te plotesuar kushtin e kontrates se ngjashme. Per sa me siper operatori ekonomik Company Riviera 2008 sh.p.k, nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT per objektin e kerkuar te prokurimit per sa i perket "Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” as per

piken a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe as per piken b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 17.08.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid MYZYRI